

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Pse Moody's rrit vlerësimin për ekonominë e Shqipërisë?
ADRESA	https://www.gazetatema.net/blogu-tema/pse-moodys-rrit-vleresimin-per-ekonome-e-shqiperise-i588563
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 14:23:56 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 15:00:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	42bd1db43b5a7ac3ba6ca711aca377468e4d1887a15dfa6f8e5d41c8c10a1942
TEKSTI	798a726353aed6e8a7bcb0f7c6105864ddc4f0266baa9e9925f2692f1752b483
PAMJA	e609bd4c178f6728b7f8368aa58f50470a5bb761ce8bf81fc750238d41f62651

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	9613c828b702cb817fc5f849da8f3c6f0b8754839da976fcd6fe52bd9c6d6f07
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c646a932fde53c288233dea515333d4375993381cb212e1a0a5e6c9db33460b4
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/9613c828b702cb817fc5f849da8f3c6f0b8754839da976fcd6fe52bd9c6d6f07>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)
- [Hosteni](#)

English

Built and Monetized by

English

le Muli nuk do te merret vesh qe Gysi eshte kunati i Gites Rikthehet Saimir Tahiri: Kam shume gjera per te thene... Trump-Xi, armepushim ne luften tregtare, SHBA dhe Kur fundit

Pse Moody's rrit vlerësimin për ekonominë e Shqipërisë?



26 Shtator 2026, 17:00Blog Nga Fatos Çoçoli

Më 19 shtator 2026, agjencia ndërkombëtare prestigjoze “Moody’s”, e vlerësimit të aftësive borxh-shlyese të mbarë ekonomive të planetit, përmes vlerësimit për ecurinë e tyre, e rriti vlerësimin për ekonominë tonë nga “e qëndrueshme” në “pozitive”.

Ky është një sinjal i rëndësishëm për mënyrën se si agjencitë ndërkombëtare të vlerësimit të kreditit(dy të tjerat janë “Standard& Poor’s” dhe “Fitch Ratings”) e shohin ecurinë dhe qëndrueshmërinë e ekonomisë së Shqipërisë.

Pse “Moody’s” e vlerëson pozitivisht uljen e borxhit publik të Shqipërisë

Agjencia ndërkombëtare ka pritshmëri që borxhi ynë publik të vijojë të ulet, në raport me prodhimin kombëtar, që e quajmë ndryshe GDP ose Prodhimi i Brendshëm Bruto i vendit, duke kaluar nga rreth 52.9 përqind tëGDPB-së në fund të vitit 2025, në rreth 50.2% në vitin 2027.

Tabela: Borxhi publik i Shqipërisë 2023-2027(në raport me GDP)

–	2023	59.2%
–	2023	54.7%
–	2025	52.9%
–	2026	51.3% (parashikim)
–	2027	50.2%(parashikimi Moody’s)

Për një ekonomi si e vendit tonë, ulja graduale e borxhit ka rëndësi të veçantë, sepse krijon më shumë hapësirë për përballimin e goditjeve të jashtme dhe përmirëson perceptimin e investitorëve të huaj mbi qëndrueshmërinë e financave tona publike.

Fakti që Moody’s pret një reduktim të borxhit nga 52.9% në 50.2% të PBB-së tregon një prirje pozitive të financave publike. Rëndësi ka jo vetëm niveli absolut i borxhit, por edhe raporti i tij me madhësinë e ekonomisë. Kur ekonomia rritet dhe borxhi mbahet nën kontroll, raporti borxh/PBB mund të ulet, edhe pa një reduktim shumë të shpejtë të borxhit.

Përmirësimi i pozicionit të jashtëm të vendit

Në përcaktimin e 19 shtatorit 2026, agjencia “Moody’s” vlerëson gjithashtu forcimin e pozicionit të jashtëm të Shqipërisë. Ky është një element i rëndësishëm për një ekonomi të vogël dhe të hapur, e cila është e ekspozuar ndaj ndryshimeve në çmimet ndërkombëtare, kursit të këmbimit, kostove të energjisë dhe kushteve financiare globale.

Një pozicion më i fortë i jashtëm e ndihmon vendin të përballojë më mirë goditjet që vijnë nga ekonomia ndërkombëtare.

Një tjetër faktor pozitiv është rritja e investimeve të huaja. Investimet e huaja direkte kanë rëndësi për ne, jo vetëm sepse sjellin kapital. Ato sjellin teknologji, njohuri menaxheriale, tregje të reja dhe vende pune, duke zgjeruar kapacitetin prodhues të ekonomisë sonë.

Nga këndvështrimi i një agjencie vlerësimi, një ekonomi që tërheq investime të huaja dhe ruan një pozicion të qëndrueshëm të jashtëm, ka më shumë kapacitet për të përballuar nevojat e saj financiare dhe goditjet e jashtme.

Rezervat valutore, një mburojë ndaj goditjeve

Një prej elementeve më të rëndësishme të përmendura nga raporti i Moody's është niveli i rezervave valutore. Rezervat valutore të Shqipërisë kanë arritur në rreth 7.9 miliardë euro në qershor 2026, duke mbuluar dukshëm më shumë se shtatë muaj importe.

Kjo përbën një rezervë të rëndësishme sigurie për ekonominë tonë. Në rast të një goditjeje të jashtme, rezervat valutore ndihmojnë ekonominë të përballojë nevojat për valutë dhe reduktojnë rrezikun që një tronditje e menjëhershme e flukseve të jashtme të krijojë probleme të mëdha financiare. Në këtë kuptim, rezervat valutore funksionojnë si një amortizator financiar.

Pse vlerësimi i Moody's ka rëndësi për investitorët e huaj?

Investitorët ndërkombëtarë shohin një grup treguesish dhe jo vetëm një element të ekonomisë.

Një kombinim i borxhit publik në rënie, i rritjes ekonomike(të cilën Moody's e parashikon 3.6 përqind për këtë vit), i financave publike më të qëndrueshme, i investimeve të huaja dhe i rezervave të konsiderueshme valutore krijon një perceptim më pozitiv për qëndrueshmërinë e ekonomisë.

Kjo është veçanërisht e rëndësishme për Shqipërinë, sepse perceptimi i rrezikut të vendit ndikon në kushtet me të cilat shteti dhe kompanitë shqiptare sigurojnë financim në tregjet ndërkombëtare. Vlerësimi i Moody's nuk lidhet vetëm me përqindjen e borxhit publik. Ai lidhet me aftësinë e përgjithshme të ekonomisë shqiptare për të ruajtur qëndrueshmërinë përballë goditjeve.

Parashikimi që borxhi publik të zbresë në rreth 50.2% të GDP-së në vitin 2027 është i rëndësishëm edhe për perspektivën afatmesme të vendit. Nëse kjo tendencë vazhdon dhe kjo duket pothuajse e sigurt, Shqipëria do të ketë mundësi të konsolidojë më tej financat publike dhe të krijojë një bazë më të qëndrueshme për investimet publike, investimet e huaja dhe zhvillimin e saj ekonomik.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Përndjekja si "meritë" politike e Flamingove

15:55 Blog

12:00 Blog / 36 komente

[Pse Rinasi po konkurron aeroportet e Rumanisë dhe Bullgarisë?](#)

08:02 Blog / 9 komente



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.